



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 653 Prot.

Tiranë, më 03.05.2019

VENDIM Nr. 107, datë 2.05.2019

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 48 dhe VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 "Për miratimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B", të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre" Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5, datë 2.05.2019, pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të projektit "Rikonstruksion i objektit ekzistues, shtesë volumi anësor dhe shtesë 2 kate, zonë arkeologjike "B" Durrës"-subjekti Z. Taulant Terpollari dhe relacionin mbi potencialin arkeologjik, konceptin e sondazheve të zonës, paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi.

VENDOSI:

1. Të miratojë konceptin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "Rikonstruksion i objektit ekzistues, shtesë volumi anësor dhe shtesë 2 kate, zonë arkeologjike "B" Durrës"-subjekti Z. Taulant Terpollari, paraqitur nga subjekt i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi.
2. Subjekti Z. Taulant Terpollari, duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë sondazhet arkeologjike, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr.384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Investitori Z. Taulant Terpollari, si dhe subjekti i licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhet arkeologjike, në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Rregullores "Mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut" (i ndryshuar) dhe akt-marrëveshjes tre palëshe të sipërcituar, janë të detyruar të marrin të gjitha masat për sigurimin dhe ruajtjen e kantierit, si dhe ruajtjen e strukturave arkeologjike, të cilat mund të zbulohen gjatë kryerjes së sondazhit, deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, në lidhje me të.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855


email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

5. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

6. Ngarkohet Sekretaria Teknike per njoftimin e ketij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al